

## AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

### “DASHI ALUMIN” SHPK

**Deshir Xhumrri**, i biri i Telha-it, i datëlindjes 30.01.1974 lindur ne Zbarqe, Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën Rruga “Ilmi Aver”, Nd. 19, H.1, Njësia Bashkiake Nr.6, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal H40130184F, bazuar ne Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” vendosa te themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “DASHI ALUMIN” SHPK, sipas parashikimeve te mëposhtme:

#### NENI 1

##### Emri i shoqërisë

Emërtimi i Plotë i Shoqërisë Tregtare është “DASHI ALUMIN” SH.P.K.

#### NENI 2

##### Selia e shoqërisë

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Tiranë në adresën “Rruga e Ndroqit”, Ura e Beshirit, Objekt 1 - katesh Nr.1. Magazine, ZK 2776.

#### NENI 3

##### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Import - eskport, prodhim, montim, tregtim, riparim dyer, dritare, fasada te permasave te ndryshme, vetrata duralumini dhe PVC. Punim dhe prodhim i dyerve, dritareve prej alumini, xhami, druri. Punim, prodhim dhe riparimimin e tendave te permasave dhe llojeve te ndryshme. Punime hekuri si dhe punime te ndryshme ndertimi. Rikonstrukcion te godinave te banimit dhe institucioneve shtetore, shkollave, kopshteve dhe cerdheve. Punime elektrike, hidraulike, izolime, termoizolime, dezinfektme. Konstruksione te ndryshme me materiale te perkoheshme apo te perhershme. Shoqeria mund te nenkontraktoje sherbimet qe ofron dhe jo vetem tek te tretet. Shoqeria mund te kryejë edhe cdo aktivitet te parashikuar nga Legjislacioni Shqiptar i cili lidhet me keto aktivitete. Per kryerjen e aktiviteteve te mesiperme per te cilat do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar qe te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

#### NENI 4

##### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributet e ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në te holla me vlerën 100 (njqind) LEKË. Kapitali themeltar ndahet në 1 kuotë, e barabartë me 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise.



Kapitali themeltar do te shlyhet nga ortaku themelues ne llogarine bankare te Shoqërisë, pas regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare të Biznesit. Nje kopje e mandat pagesave bankare te shlyerjes se kapitalit themeltar nga ana e Ortakut të Shoqërisë, depozitohet ne Qendrën Kombëtare të Biznesit si deklarim vullnetar nga Administratori i Shoqërisë.

#### NENI 5 Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### NENI 6 Organet Drejtuese

Ne zbatim te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të Shoqërisë janë si më poshtë vijon :

1. Asambleja e Përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

Mënyra e organizimit dhe funksionimit te ketyre organeve rregullohet dhe ushtrohet sipas parashikimeve të Statutit te Shoqërisë dhe legjislacionit ne fuqi.

Shoqëria do të perfaqësohet ligjërisht nga Administratori i saj e cila është **Reida Xhumrri**, e bija e Deshir-it, e datëlindjes 11.10.1998 lindur dhe banuese në Tiranë në adresën Rruga “Ilmi Aver”, Nd. 19,H.1 Njësia Bashkiake Nr.6, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me Nr. Personal J86011046W.

#### NENI 7 Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe.

Me nënshkrimin e ketij Akt Themelimi, ortaku themelues detyrohet qe te hartojë dhe nënshkruajë Statutin e Shoqërisë, një kopje e te cilit do te depozitohet ne QKB.

Ngarkohet Ortaku ose Administratori i Shoqërisë që të kryejnë procedurat e Regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Biznesit. Këtë detyrim, ata mund ta kryejë personalisht, ose përmes personave të caktuar prej tyre me Prokurë të Posaçme.

---

**Ortaku Themelues**

Dt. 26.01.2021

**DESHIR XHUMRRI**

